



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

RREGULLORE
PËR MOBILITET AKADEMIK TË STUDENTËVE NË KOLEGJIN
BIZNESI PRISHTINË

Prishtinë 2020

Rregullorja për mobilitet akademik të studentëve në Kolegjin BIZNESI Prishtinë është hartuar në mbështetje të Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, në Statutin e Kolegjit neni 81; në Rregullore e brendshme e Kolegjit BIZNESI, kreu IV dhe neni 45.,46.,48.,52.dhe 53.; si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe që është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, të Kolegjit BIZNESI, me datë 25.09.2020, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR MOBILITET AKADEMIK TË STUDENTËVE NË KOLEGJIN BIZNESI PRISHTINË

Neni 1Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është respektimi i të gjitha standardeve të Bashkimit Evropian që orientojnë Institucionet e Arsimit të Lartë drejt integritimit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Hapësirën Evropiane të Hulumtimeve Shkencore, dhe atë, duke respektuar deklaratën eProcesit të Bolonjës dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës për inkurajimin dhe promovimin e mobilitetit akademik dhe personelit (2011/C 199/01). Gjithashtu me këtë Rregullore, Qendres dhe dega në Prizren iu kërkohet që t'i zbatojnë procedurat para dhe pas përfundimit të Mobilitetit Akademik (në tekstin e mëtejme MA):

Neni 2

Obligime detyrimet e qendres dhe degës ndaj studentit gjatë procesit të MA-së.

1. Qendra dhe dega obligohen të bëjë shqyrtimin e dokumenteve të studentëve, të cilat i nënshtrohen procesit të aplikimit për mobilitet. Qendra dhe dega duhet të kërkojë nga studentit që të sigurojë të dhënat dhe dëshmitë e nevojshme, siç janë:

-Lista e lëndëve që planifikon studentit t'i ndjekë gjatë programit të mobilitetit në Universitetin/ Kolegjin pritës dhe ECTS-të (kreditë) për secilën lëndë të përzgjedhur.

2. Të shqyrtojë kërkesën e studentit për ndryshim eventual të lëndëve gjatë realizimit të mobilitetit në Universitetin/Kolegjin pritës (në qoftë se ndodhë ndryshimi i lëndëve me kërkesën e Universitetit/kolegjit pritës). Transferin e kredive — ECTS-ve (pas kthimit të studentit në Kolegjin BIZNESI, si:

1. Transkriptin e notave nga universiteti/kolegji pritës;

2.Marrveshjen e mësimimit (Learning Agreement).

Neni 3

Procedurat para fillimit të Mobilitetit Akademik të studentit

1. Dokumentet e kandidatit për shqyrtim, dorëzohen tek përgjegjësi i administratës së kolegjit.
2. Përgjegjësi i administratës, e bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe bën krahasimin e lëndëve të përzgjedhura nga studenti. Në rast nevojë procesi ndihmohet nga përgjegjësi i programit .
3. Në rast kur lëndët përzgjedhura nga studenti, janë të krahasueshme me lëndët e programit studimor deri në 70%, apo identike, marrëveshja e mësimit, me propozim të përgjegjësit të administratës, duhet të nënshkruhet nga Komisioni për pranimin e njohjeve, ku konfirmohet se lëndet e përzgjedhura nga studenti do të pranohen si të tilla në programin përkatës, pas kthimit të studentit në universiteti/kolegjin amë amë.
4. Në rast se lëndët e përzgjedhura nuk janë të krahasueshme deri në masë 70%, mirëpo i përkasin fushës së njëjtë të studimit, përgjegjësi i administratës i kërkon/sugjeron studentit që t'i ndryshojë lëndët e përzgjedhura duke e orientuar në lëndë që kanë krahasueshmeri deri në 70%.
5. Në rast se lista e lëndëve në Universitetin/kolegjin pritës nuk përmban lëndë të krahasueshme deri në 70% konfirmimi për mundësinë e pranimit dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së mësimit duhet të merret nga përgjegjësi i administratës në bashkëpunim me udhëheqësin e departamentit ose programit të studimit, sipas nevojës edhe komisionit për njohje, kur marrin vendim final për aprovim duke:
 - 5.1. E shqyrtuar mundësinë e pranimit të lëndës si lëndë zgjedhore, ose
 - 5.2. Të njihen vetë si ECTS kredi shtesë në shtojcën e diplomës.
2. Procesi i shqyrtimit të aplikacionit të studentit duhet të përmbyllet në afatin kohor deri në 7 ditë nga dita kur studenti aplikon për Mobilitet Akademik.

Neni 4

Njohja e Mobilitetit Akademik

1. Lëndët e fituara në një Universitet/kolegj jashtë vendit, të cilat janë të ngjashme apo identike me lëndët e ofruara në programin e studimit të Programeve përkatës të Kolegjit BIZNESI duhen të pranohen pa asnjë mëdyshje dhe pa asnjë pengesë nga Programi amë (BIZNESI) dhe të regjistrohen Përgjegjësi i administratës, bazuar në vendimin e Komisionit për njohje dhe në dosje i bashkëngjitet vendimi/procesverbali i Komisionit për njohje.
2. Lëndët të cilat i përshtaten profilit të programit, të cilat janë dhënë nga Universitetet/kolegjet e huaja të akredituara dhe me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi, mirëpo, të cilat nuk i kemi në plan programin mësimor, ekuivalentimi, apo njohja e këtyre lëndëve bëhet përmes krahasimit të rezultateve të të nxënit.
3. Lëndët e fituara në një Universitet të huaj, e cila ka emertim të ndryshëm nga lënda e ofruar në program të studimit në Departamentin amë (BIZNESI) apo që kanë ngarkesë të ndryshme të studentit

dhe rrjedhimisht kanë peshë të ndryshme, ajo lëndë mund të i pranohet nga Programi përkatës, dhe atë me emertim të njejt si në programin e ofruar në \programin përkatës amë, me kusht që rezultatet e të nxenit të jenë të ngjashme.

4.Nota regjistrohet nga përgjegjësi i administratës .

4.1.Studenti që aplikon për mobilitet në universitetin/kolegjin pritës (tjetër) nuk mund të përzgjedh lëndët që i ka të dhënuna në universitetin amë.. Lëndët e tilla nuk pranohen për shqyrtim.

4.2.Lëndët të cilat në një universitet janë në nivelin Bachelor ndersa në tjetrin në nivelin Master (dhe anasjelltas), studenti mund të zgjedh deri në dy lëndë, të nivelit të ndryshëm të studimit që të ekuivalentohen në universitetin/kolegjin amë në nivelin e studimeve përkatëse.

4.3.Kredit ECTS kredive,nga mobiliteti i studenteve, të fituara në Universitetin veror, i pranohen studenteve sipas kapitulli 3 të kësaj rregulloreje.

5.Transferi i ECTS kredive, për lëndët obligative me përmbajtja të njëjtë, por që dallon numri i ECTS kredive e, këto lëndë duhet të pranohen.

6.Marrëveshja e mësimit, mund të pësojë ndryshime edhe pasi që studenti të ketë filluar mobilitetin meqë diçka e tillë parashihet edhe në programet e ndryshme ndërkombëtare (Erasmus +. etj.).

Ndryshimet eventuale duhet të bëhen në koordinim me:

- a. studentin
- b. fakultetin/Programin pritës, dhe
- c. fakultetin dërgues.

7.Nënshkrimi i marrveshtjës së mësimit nënkupton që pas realizimit të Mobilitetit Akademik të studentit dhe pas dëshmisë me shkrim se lëndët e zgjedhura paraprakisht nga studentit, të cilat janë të evidentuara në marrëveshje të mësimit janë vlerësuar me nota kaluese, në menyrë automatike e bëhet pranimi i lëndëve dhe ECTS kredive në Kolegjin BIZNESI. Mos pranimi i lëndëve mund të ndodh vetëm në rast se:

a.Studenti nuk i ka kaluar provimet në universitetin/kolegjin pritës, dhe

b.Nuk i ka akumuluar ECTS-të kreditë sipas marrëveshjes së mësimit

8.Në rastet kur njësia Akadematike e Universitetit/Kolegjit amë, obligohet të japë arsyetim dhe dëshmi me shkrim për mos pranimin e lëndëve dhe ECTS-ve.

9.Në rast se studenti përfitues i mobilitetit bën shkelje etike në universitetin pritës, përveq masave ndëshkimore që do të merr nga universiteti/kolegji po i njëjti do të i nënshtrohet procedurës disiplinore nga Kolegji BIZNESI Prishtinë

10.Periudha kohore që duhet përmbyllur procesi i shqyrtimit dhe njohjes së lëndëve në Kolegjin BIZNESI pas kthimit nga universiteti/kolegji pritës duhet të bëhet brenda 15 ditë

pune.

Neni 5

Llojet e aktiviteteve e jashtë programeve mesimore

1. Aktivitetet jashtë programeve mesimore janë aktivitetet te cilat nuk janë paraparë në kuadër të programeve të akredituara mesimore Administratën e Kolegjit. Të tilla konsiderohen aktivitetet si në vijim:

1.1. Ndjekja e kurseve mesimore të ofruara në kuadër të Universitetit Veror;

1.2. Ndjekja e kurseve mesimore të ofruara nga Qendrat përkatëse;

1.3. Pjesërnarrja aktive në organizime afatshkurta mesimore (punëtori, seminare e të ngjajshme) të organizuara nga Kolegji.

Neni 6

Menyra e llogaritjes se kredive ECTS

Një kredi ECTS korrespondon me ngarkesën e studentit nga 25 deri në 30 orë aktive akademike

Neni 7

Procedura e ndarjes së kredive ECTS

1. Ndarja e krediveve ECTS mund të bëhet në bazë të kërkesës së bartësit të aktivitetit të caktuar, nëse i njëjti ka kontratë të rregullt me Kolegjin BISNESI dhe së paku thirrjen akademik prof. Ass.

2. Kërkesa e bartësit të aktivitetit duhet të paraqitet para se të fillojë organizimi i aktivitetit të caktuar dhe të mbështetet në formë të shkruar nga udhëheqësi i organizimit (ngjarjes) në kuadër të të cilit parashihet zhvillimi i aktivitetit respektiv.

3. Kërkesa duhet të paraqitet nëpërmjet formularit të standardizuar (mund të shkarkohen nga Veb-faqja e KOLEGJIT).

4. Vendimi për ndarjen e kredive ECTS merret në Komisionin e formuar për këtë qëllim dhe nënshkruhet nga Dekani.

Neni 8

Pranimi i kredive ECTS

1.Studentët të cilët kanë fituar kredi ECTS në përputhje me këtë rregullore, mund të parashtrojnë kërkesë pranë administratës për bartjen e kredive ECTS në programin në të cilin ata janë regjistruar, me qëllim të zëvendësimit të pjesshëm ose të plotë të një ose më shumë lëndëve zgjedhore. Bartja e kredive lejohet në këto raste:

1.1.Nëse studenti iu ka nënshtruar provimit në kursin e caktuar në kuadër të aktiviteteve jashtë programeve mësimore dhe përmbajtja e aktivitetit përputhet në masën 70 % ose më shumë me përmbajtjen e lëndës së caktuar zgjedhore, të njëjtit i pranohet në tërësi kursi, nota dhe kreditë ECTS të fituara.

1.2.Në rast se numri i kredive ECTS të kursit të pranuar nga aktivitetet jashtë programeve mësimore nuk përputhet me numrin e kredive ECTS të lëndës zgjedhore respektive, kompenzimin e ECTS-ve studenti duhet ta realizojë me ndonjë lëndë tjetër zgjedhore që ofrohet në programin ku i njëjti është regjistruar.

1.3.Nëse studenti ka ndjekur kursin e caktuar në kuadër të aktiviteteve jashtë programeve mësimore (por nuk i është nënshtruar provimit) dhe përmbajtja e aktivitetet përputhet në masën 70 % ose më shumë me lëndën e caktuar zgjedhore, studenti ka të drejtë t'i nënshtrohet provimit në lëndën përkatëse zgjedhore pa e dëgjuar të njëjtën. Në rast të përfundimit me sukses të provimit, studenti merr kreditë ECTS të parapara për lëndën zgjedhore respektive në kuadër të programit përkatës.

1.4.Nëse studentit nuk i pranohen kreditë ECTS për shkak të mospërputhjes së përmbajtjes në masën e kërkuar me lëndët e programit në të cilën ai është i regjistruar, kreditë ECTS të njëjtit i barten në shtojcën e diplomës.

1.Si aktivitet jashtë programeve mësimore nuk mund të llogaritet kursi nëse i njëjti ofrohet në programet e akredituara në të cilat është regjistruar studenti. Komisioni i studimeve në nivel të Kolegjit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës dhe nxjerrjen e vendimit përkatës në lidhje me pranimin e kredive ECTS të ftuara në përputhje me këtë rregullore.

Neni 9


Raportimi në lidhje me aktivitetet jashtë programeve mësimore

Pas përfundimit të aktiviteteve jashtë programeve mësimore, udhëheqësi i organizimit të tillë është i obliguar që t'i ofrojë raportin përkatës Dekanit brenda 3 muajve, pas përfundimit të aktiviteteve. Raporti duhet të përmbajë të dhëna në lidhje me aktivitetet e realizuara, pjesëmarrësit dhe cilësinë e pjesëmarrjes së tyre, rezultatet e të nxënit, kreditë ECTS dhe çertifikatat e lëshuara.

Neni 10

Dispozitat kalimtare

Dispozitat e kësaj Rregulloreje hyjnë në fuqi nga dita e miratimit në KLMSH.



KLMSH i Kolegjit BIZNESI
Kryetari

/Prof Dr Shyqeri Kabashi /